



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVJA - MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org.	Nr. Prot:
Org.Jedinica	Etnj.Prot:
Org Unit	prot.No 05-8552
Nr.i faqeve	Data:
Br.stranica	Datum:
No.pages	Date: 28/12/2023
- 26 -	
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrat/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.229/XII/2023
Datë:27.12.2023

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në shtojcën 1 , pika 6.1 Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

- I. Aprovohet Udhëzuesi për zbatimin e programit psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje.
- II. Shtojce e këtij vendimi është, Udhëzuesi për zbatimin e programit psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Arben Viti
Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Arkivit të MSh.

UDHËZUESI PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PSIKOSOCIAL ME AKTIVITETE OKUPUESE PËR TRAJTIMIN E RASTEVE ME PROBLEME TË SHËNDETIT MENDOR NË BURGJE

Konceptet e vacanta

Okupacionale – aktivitete ose detyrë me te cilën ngarkohet pacienti me qellim terapeutik;

Kognitive – procese psiqike qe lidhen me njohjen e realitetit përmes mendimit dhe arsyetimit;

Funksionet e pavarura – aftësitë elementare jetësore për të i shërbyer vetes me qellim te mos qenë i varur fizikisht nga të tjerët;

Shenja joverbale – të gjitha shenjat ose simbolet joverbale të cilat e ndihmojnë personin të orientohet në aspektin fizik dhe emocional;

Mindfulness - është aftësi themelore e njeriut për të qenë plotësisht të pranishëm, i vetëdijshëm se ku është dhe çfarë po bën, dhe jo tepër reagues ose të mbingarkuar nga ajo që po ndodh rreth nesh;

Përbajtja:

I.	HYRJE	3
A.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I QËLLIMIT DHE OBJEKTIVAVE TË UDHEZUESIT TË PROGRAMIT	3
	Kognitive / Njohëse	3
	Aspekti fizik	4
	Funksionimi i pavarur	4
B.	VLERËSIMI.....	5
	Vlerësimi fillestar	5
	Qëllimi dhe fushat e vlerësimit	5
	Metodat dhe mjetet vlerësuese	5
	Vlerësimi në proces	6
C.	PLANI I INDIVIDUALIZUAR I TRAJTIMIT	7
	Aktivitete në zhvillimin e aftësive njohëse	7
	Aktivitete në zhvillimin e aftësive fizike / psikomotorrike	7
	Aktivitete në zhvillimin (mundesimi) funksionimit	8
	Shtojca 1	9
	Shtojca 2	11
	Shtojca 3	12
	Referencat.....	14
	Grupi punues	15
	Grupi punues i zgjeruar	16

I. HYRJE

Udhëzuesi për zbatimin programi psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje është një plan gjithëpërfshirëse që synon trajtimin e pacientëve me probleme të shëndetit mendore në rritjen e funksioneve jetësore dhe përmirësimin e simptomave që dëmtojnë kualitetin e jetës, në funksion të lehtësimit të ri integrimit të tyre të suksesshëm në shoqëri. Ky program potencon rëndësinë e adresimit të nevojave si për trajtim profesional ashtu edhe për rehabilitim për të nxitur rritjen personale, për të reduktuar shkallën e recidivizmit dhe për të përmirësuar perspektivat e funksionimit pas lirimt. Duke kombinuar ndërhyrjen okupacionale dhe planifikimin e ri integrimit në komunitet, ky program ofron një qasje holistike për të fuqizuar individët dhe për të nxitur ndryshime pozitive. Nëpërmjet këtij programi, pjesëmarrësit kanë mundësinë të fitojnë aftësi vetëregulluese, të adresojnë sfidat personale dhe të ndërtojnë një themel për një të ardhme më të qëndrueshme pas kalimit të tyre në komunitet.

A. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I QËLLIMIT DHE OBJEKTIVAVE TË UDHEZUESIT TË PROGRAMIT

Udhëzuesi për zbatimin programit me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje është hartuar me një grup qëllimesh për të vlerësuar dhe adresuar nevojat unike të pacientëve dhe për të promovuar rehabilitimin dhe ri integrimin e tyre të suksesshëm në shoqëri. Programi, përmes tri fushave të shpërndara në 23 aktivitetet e shtrirë në harkun kohore nga 30 deri në 90 ditë sipas nevojave, synon të ofrojë një gamë gjithëpërfshirëse të mundësive të trajtimit profesional me përzgjedhje të aktiviteteve adekuate për personin sipas planit individual, së bashku me ofrimin e rehabilitimit, për të nxitur rritjen personale, punësimin dhe ndryshimin pozitiv të sjelljes. Duke kombinuar ndërhyrjet okupacionale me zhvillimin e aftësive profesionale dhe me planifikimin e ri integrimit. Tek klienti programi përpinqet të arrijë qëllimet, zhvillimin e aftësive të mëposhtme:

Kognitive / Njohëse

- 1. Mbajtja mend e një liste – Rikujtimi dhe mbajtja në kujtesë janë qëllimet kryesore për terapinë konjitive okupacionale
- 2. Të mësuarit e shenjave joverbale – Për pacientët me dëmtime të aftësive njohëse, të mësuarit e shenjave sociale është një hap i rëndësishëm në rrugën drejt zhvillimit të marrëdhënieve kuptimplotë.
- 3. Praktikimi i teknikave për uljen e stresit - Vendosja si qëllim për të medituar ose praktikuar tekniken e "mindfulness" të paktën një herë në ditë ose disa herë në javë mund të ndihmojë kundrejt stresit dhe pamundësive mendore (impairment) përmes aktiviteteve të terapisë okupacionale.

- 4. Përmirësimi harkut kohorë përqendrimit te vëmendjes - Ky qëllim mund të matet me kohën e kaluar duke u angazhuar në një ligjëraturë online, duke lexuar një libër ose duke qëndruar në një bisedë.

Aspekti fizik

1. Aftësia e kapjes së objekteve - Kapja e objekteve është çelës për shumë aktivitete të përditshme dhe kërkon jo vetëm forcën e dorës, por koordinim dhe shkathtësi.
2. Qëndrimi i zgjatur në këmbë - Aftësia për të qëndruar në këmbë për një kohë që shkon duke u rritur është qëllim kryesor për shumë pacientë ne terapi okupuese.
3. Ecja - Qëllimi logjik për të ndjekur qëndrimin e gjatë në këmbë është ecja si i pavarur.
4. Përmirësimi i Koordinimit Dorë-Sy - Ekzistojnë një sërë ushtrimesh për të trajnuar dhe matur aftësinë e pacientëve për t'i bërë duart e tyre të shkojnë atje ku mendja e tyre i synon.

Funksionimi i pavarur

1. Veshja - Te veshësh kërkon një nivel të caktuar aftësie për tu ngritur apo edhe për të qëndruar ulur, përveç aftësisë kërkon edhe shkathtësi.
2. Te ushqyerit e pavarur - Te ushqyerit e pavarur mund të përfshijë gatimin e një vakti për veten, si dhe aftësinë për të u vet ushqyer.
3. Përdorimi i pavarur i banjës - Dëmtimet, sëmundjet mendore shpesh nënkuftojnë humbje të privatësisë. Përdorimi i pavarur i tualetit është një shenjë kyçe e rikthimit te aftësisë dhe pavarësisë.
4. Punësimi - Për shumë pacientë me terapi, ky është qëllimi përfundimtar: të jenë në gjendje të sigurojnë dhe të mbajnë me sukses punësimin afatgjatë.

B. VLERËSIMI

Vlerësimi dhe plani i individualizuar janë komponentë thelbësorë të trajtimit. Këto procese sigurojnë që udhëzuesi i programi psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje plotëson nevojat dhe aftësitë unike të secilit pjesëmarrës. Këtu është një përbledhje e procesit të vlerësimit dhe planit të individualizuar:

Vlerësimi i aftësive dhe zbatimi i aktivitetave ofrohet nga anëtarët e ekipit multidisiplinar, përbërja e të cilët i përshtatet planit individual ose grupor të trajtimit, të emëruar nga institucioni sipas specifikave të tij.

Vlerësimi fillestare

Qëllimi dhe fushat e vlerësimit

Vlerësimi i aftësive dhe nevojave të pacientëve në tri fushat e lartpërmendura: aftësitë kognitive, aftësitë fizike dhe funksionimit është proces baze para se pacienti të kyçet ne programin psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje.

Vlerësimi dhe përcaktimi i nivelit të aftësive të pacientit në fushat përkatëse organizohet dhe realizohet përmes ekipit multidisipinar.

Ekipi multidisiplinar fillimisht takon dhe vlerëson pacientin e rekonduar në programin psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje përmes zbatimit te pyetësorit specifik për matjen e aftësive dhe nevojave të tij në tri fushat specifike.

Metodat dhe mjetet vlerësuese

Lista për vlerësimin e aftësive dhe nevojave është mjet, dokument përbërës i udhëzuesit të programit psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje, dhe përbëhet nga tri pjesë, secila pjesë përbëhet nga pyetje dhe detyra të cilat matin aftësitë dhe nevojat e pacientit. Pjesa e parë matë aftësitë dhe nevojat në fushën kognitive/njohëse, pjesa e dytë në fushën e aftësive fizike dhe pjesa e tretë në fushën e funksioneve (shih shtojcën 2).

Pas vlerësimit, niveli i aftësive përcaktohet nga ekipi multidisciplinar duke përdorur njësinë matëse nga 1 deri 10, ku 1 tregon se i vlerësuari nuk e ka aspak të zhvilluar aftësinë përkatëse (për të cilën vlerësohet), ndërsa mbi 5 konsiderohet se i vlerësuari zotëron aftësi të mjaftueshme për të funksionuar.

Ne kuadër të listës për vlerësimin e aftësive dhe nevojave në proces të vlerësimit mund të përdoren testet psikologjike, *checklistat*, intervista, vlerësimi i dosjes mjekësore dhe dokumenteve të tjera të klientit.

Nga ekipi multidisiplinar vlerësimi dhe zbatimi i udhëzuesit organizohet sipas këtij formati (tabela ne vijim):

Varësisht nga gjetjet në procesin e vlerësimit, ekipi multidisiplinar përcakton domosdoshmérinë ose jo përfshirjen e pacientit ne programin psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje. Njëkohësisht të dhënat e këtij vlerësimi fillostar përcaktojnë edhe planin individual të trajtimit bazuar në nevojat dhe aftësitë e shfaqura në të. Varësisht se në cilën fushë maten nevoja me të mëdha aplikohen edhe ushtrimet përvillimin e aftësive përkatëse në atë fushë.

Po ashtu varësisht në gjetjet e vlerësimit ekipi multidisiplinar përcakton edhe harkun kohore, përkatësisht numri e seancave te cilat duhet te i ndjeke klienti.

Tabela Nr. 1 Ndarjet sipas fushës së vlerësimit, profesionistit vlerësues dhe metodologjisë së nevojshme

Nr.	FUSHA VLERESIMIT	E PROFESIONISTI VLERESUES	METODOLOGJIA	MJETI	PER VLERESIM
1	Aftësitë njohëse	Psikologu klinik / Psikiatri Profesionistet e licencuar të fushës ose staf i trajnuar në këtë fushë	Testet përmatjen e aftësive njohëse Intervista		
2	Aspekti fizik	Mjeku / Psikiatri Profesionistet e licencuar të fushës ose staf i trajnuar në këtë fushë	Testet fizike Intervista		Vlerësimi i dosjes mjekësore
3	Funksionet jetësore	Mjeku / infermieri Profesionistet e licencuar të fushës ose staf i trajnuar në këtë fushe	Intervista		Vlerësimi i dosjes mjekësore

Vlerësimi në proces

Vlerësimi ne proces te zbatimit te programit psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje bëhet me qellim të matjes së progresit pozitiv të pacientit, përkatësisht efikasitetit të programit, ose edhe modelimit apo ndryshimit të planit individual varësisht nga rrjedha e procesit. Ky proces zbatohet nga i njëjti ekip multidisiplinar dhe përmes të njëjtë mjet vlerësues - listës për vlerësimin e aftësive dhe nevojave.

Intervali i aplikimit te këtij vlerësimi behet nga paneli multidisiplinar i përcaktuar për zbatimin e programit tek klienti përkatës, sipas planit individual te trajtimit.

C. PLANI I INDIVIDUALIZUAR I TRAJTIMIT

Plani i individualizuar i trajtimit përbënë komponentë thelbësorë të trajtimit². Ky proces siguron që udhëzuesi për zbatimin e programit psikosocial me aktivitete okupuese për trajtimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor në burgje, respekton dhe plotëson nevojat dhe aftësitë unike të secilit pjesëmarrës. Këtu kemi një përbledhje të procesit të planit të individualizuar sipas detyrave dhe aktivitetave terapeutike të përcaktuara me lartë, duke mos përashtuar mundësinë që ekipi multidisiplinar të rekomandoj përfshirjen e pacientit në programet dhe aktivitetet rutinore që ofron burgu në funksion të zhvillimit të aftësive në fushën përkatëse⁴:

Aktivitete në zhvillimin e aftësive njohëse

Aktivitete dhe detyrat e kësaj fushe kanë për qellim zhvillimin e aftësive njohëse të pacientet për të cilat në vlerësim është konstatuar se kjo është një nevoje e tyre në drejtim të zhvillimit dhe arritjes së funksioneve jetësor. Detyrat në vijim jepin detaje lidhur me qëllimin dhe formën e zbatimit në program:

- a) **Mbajtja mend e një liste** – Rikujtimi dhe mbajtja në kujtesë janë qëllimet kryesore për terapinë njohëse okupacionale (8 sesione, përkatësisht ¼ e sesionit).
- b) **Të mësuarit e shenjave joverbale** – Për pacientët me dëmtime të aftësive njohëse, të mësuarit e shenjave sociale është një hap i rëndësishëm në rrugën drejt zhvillimit të marrëdhënieve kuptimplotë (8 sesione, përkatësisht ¼ e sesionit).
- c) **Praktikimi i teknikave për uljen e stresit** - Vendasja si qëllim për të medituar ose praktikuar tekniken e “mindfulness” të paktën një herë në ditë ose disa herë në javë mund të ndihmojë kundrejt stresit dhe vështirësive mendore përmes aktiviteteve të terapisë okupacionale. Duke përfshirë rregullimi emocional. Ky aspekt synon të rrisë aftësitë vetërregulluese emocionale të pacientit në shërbim të funksionimit me të lehtë. (Numri i sesioneve përcaktohet nga profesionisti që ofron këtë pjesë të programit).
- d) **Përmirësimi harkut kohorë përqendrimit të vëmendjes** - Ky qëllim mund të matet me kohën e kaluar duke u angazhuar në një ligjératë online, duke lexuar një libër ose duke qëndruar në një bisedë (8 sesione, përkatësisht ¼ e sesionit).

Detyrat e poshtëshënuara përfshijnë aktivitete okupuese të cilat synojnë që të rrisin aftësitë njohëse. Në tabele janë të përshkruara detyrat, kohëzgjatja e zbatimit, materialet e nevojshme, qëllimi, përshkrimi i hapave të aktivitetit dhe referenca.

Aktivitete në zhvillimin e aftësive fizike / psikomotorrike

Aktivitete dhe detyrat e kësaj fushe kanë për qellim zhvillimin e aftësive fizike, përkatësisht psikomotorrike të pacientit për të cilat në vlerësim është konstatuar se kjo është një nevojë e tyre në drejtim të zhvillimit dhe arritjes së funksioneve jetësore.

- a. Aftësia e kapjes së objekteve - ushtrime që mbështesin zhvillimin e koordinimit të aftësive psikomotore për të mbajtur objektet e nevojshme për funksionim.
- b. Qëndrimi i zgjatur në këmbë – përcaktimi i detyrave, përshtatja e kushteve arkitektonike dhe përpilimi i famës për evidentimin e aktivitetit, për shembull: krijimi i vijave ne sallat

- e ushtrimeve, me njësi matëse (formular i veçante për vlerësimin e kohës së qëndrimit nga sesioni në sesion).
- Ecja - përcaktimi i detyrave, përshtatja e kushteve arkitektonike dhe përpilimi i famës për evidentimin e aktivitetit.
 - Përmirësimi i Koordinimit Dorë-Sy - përcaktimi i llojit te ushtrimit dhe përpilimi i famës për evidentimin e aktivitetit.

Aktivitete në zhvillimin (mundesimi) funksionimit

Aktivitete dhe detyrat e kësaj fushë kanë për qellim kthimin e funksioneve të domosdoshme të pacientit për të cilat në vlerësim është konstatuar se kjo është një nevojë e tyre në drejtim të zhvillimit dhe arritjes së kompetencës jetësore.

- Veshja – të zhvillohen lista të aktiviteteve lidhur me veshjen dhe mirëmbajjen e teshave.
- Te ushqyerit e pavarur – të krijohen mundësi dhe plane për zhvillimin e aftësive për përgatitjen e ushqimit për veten dhe të tjerët (bashkëpunimi me kuzhinën e burgut, pas vlerësimit klinik të rrezikshmërisë).
- Përdorimi i pavarur i banjës – të zhvillohen detyra dhe lista për përcjelljen e funksionit.
- Punësimi – në këtë program duhet të përfshihen të gjitha aktivitete dhe programet e rregullta që ofron burgu si mundësi për komisionin multidisiplinar të përcaktuuar për trajtim me këtë program. Programet dhe aktivitete e tillë duhet të ndërlidhen me detyrat e këtij programi në funksion të trajtimit sipas vlerësimit të nevojave individuale të pacientit.

Tabela në vijim paraqet përbledhjen e aktiviteteve të detajuara për zbatimin e programit ku saktësohet lloji i detyrës, kohëzgjatja e zbatimit, materialet e nevojshme, qëllimi dhe përshkrimi i hapave të aktivitetit, të cilat janë të renditura sipas fushës së intervenimit. Disa prej aktiviteteve mbulojnë disa fusha të intervenimit, ku të tjerat janë të përcaktuara vetëm për një fushe te vetme.

Përgjegjësia e zbatimit të aktivitetit është e shpërndarë sipas tabelës për vlerësim (Tabela 1)

Shtojca 1

DETYRAT, AKTIVITETE E PER ZBATIMIN E PROGRAMIT TE SAKTESUARA SIPAS EMERIMIT, KOHEZGJATJES, MATERIALET E NEVOJSHME, QELLIMI, PERSHKRIMI I HAPAVE TE AKTIVITETIT DHE FUSHA E INTERVENIMIT

Nr	Detyra	Kohëzgjatja Zbatuesi i ushtrimit	Materialet e nevojshme	Qellimi	Pershkrimi i hapave te aktivitetit	Fusha e intervenimit
1	Relaksimi / Meditimi	20-30 min	Dhoma për relaksim dhe meditim	Ulja e nivelit te stresit	Ekspozimi ne hapësirën e relaksimit	Njohëse
2	5, 4, 3, 2, 1	5-10 min	Pajisje për 5 shqisat	Ulja e nivelit te stresit	Ekspozimi i klientit ne aktivitete për secilën shqisë	Njohëse
3	Zbatimi i teknikave te frymëzuarjes	5-10 min	Biofeedback dots/ Electromyogram	Ulja e nivelit te stresit	Zbatimi i teknikave te frymëzuarjes dhe teknikave te tjera te biofeedbackut	Njohëse
4	Katalogu me shenjat për orientim në hapësira të urbanizuar	10-15 min	Karta fizike të plastifikuara me ngjyra	Të mësuarit e shenjave jo verbale / orientimi në hapësirë urbane	Prezantimi i shenjave veç e veç. Kërkohet nga pacienti të identifikoj dhe interpretoj	Njohëse
5	Skenimi trupit	15-20 min	Dhoma për relaksim dhe meditim dhe yogamats	Ulja e nivelit te stresit dhe rritja e përqendrimit	Shpjegimi Demonstrimi Praktikimi	Njohëse
6	Katalogu me figurat e shprehjes emocionale në ftyrë	15-20 min	Karta fizike te plastifikuara me ngjyra	Të mësuarit e shenjave jo verbale/ emocione	Prezantimi i kartës veç e veç. Kërkohet nga pacienti të identifikoj emocionet	Njohëse
7	Loja me karta qifte	10- 30 min	Karta ne forme fizike	Forcimi i mbamendjes	Shpjegimi Demonstrimi Praktikimi	Njohëse dhe fizike
8	Puzzle - kompletimi i figurës	10-30 min	Seti i copëzave të figurave	Forcimi i i orientimit, vëmendjes dhe kujtesës	Shpjegimi Demonstrimi Praktikimi	Njohëse dhe fizike
9	Rruaza në pe	10-30 min	Rruaza me ngjyra të ndryshme, pe, gjilpëra	Zhvillimi i aftësive psikomotorrike	Demonstrimi	Njohëse dhe fizike
10	Terapia Muzikore	40 + min	Dhoma akustike me instrumentet muzikore	Ulja e nivelit të stresit dhe rritja e aftësive	Shpjegimi Demonstrimi Praktikimi	Njohëse, fizike dhe funksionet

11	Terapia e Artit	40+ min	Pajisjet shkollore. Plastelina, ngjyra, fleta, etj.	Ulja e nivelit te stresit dhe rritja e aftësive	Shpjegimi Demonstrimi Praktikimi	Njohëse, fizike dhe funksionet
12	Loja me top ose sfere	5-10 min	Topa të madhësive të ndryshme	Zhvillim motrik i kapjes së objekteve	Ndërveprimi midis profesionistit dhe pacientit	Fizik
13	Detyra me plastelina	20-30 min	Set i plastelinave me ngjyra të ndryshme	Zhvillim i kapjes dhe formësimit të objekteve	Profesionisti propozon formen ose modelin e figurës	Fizik
14	Videolojra	30-40 min	Pajisje për videolojra	Zhvillimi i koordinimit dore-sy	Shpjegimi Demonstrimi Praktikimi	Fizik
15	Ecje	20-30 min	Hapësira për ecje, forma e evidentimit të kohës dhe gjatësisë	Zhvillimi i aftësisë së ecjes	Shpjegimi Demonstrimi Praktikimi	Fizik
16	Zbatimi i teknikave te tokëzimit	20-30 min	Vizatimi i segmenteve në dyshemë	Zhvillimi i aftësisë së qëndrimit në këmbë dhe ecjes	Shpjegimi Demonstrimi Praktikimi	Fizik
17	Mësimi përmes videove për proceduarat e veshjeve	20-30 minuta	TV	Të mësuarit e aftësisë së veshjes	Bashke interpretimi i videos me pacientin	Funksionet
18	Zbatimi i proceduarve të veshjes	20-30 min Në mëngjes dhe mbrëmje	Rroba	Të mësuarit e aftësisë së veshjes	Mbështetje në proceduar e veshjes	Funksionet
19	Shikimi i videove për proceduara e ushqimit	20-30 minuta	TV	Të mësuarit e aftësisë së të ushqyerit	Bashke interpretimi i videos me pacientin	Funksionet
20	Zbatimi i proceduarve të të ushqyerit	20-30 min Në mëngjes, dreke dhe mbrëmje	Kuzhina e përshtatshme	Të mësuarit e aftësisë së ushqyerjes	Mbështetje ne proceduar e ushqimit	Funksionet
21	Shikimi i videove për proceduara e banjos	20-30 minuta	TV	Të mësuarit e aftësisë së përdorimit të banjos	Bashke interpretimi i videos me pacientin	Funksionet
22	Zbatimi i procedurave të banjos	20-30 min	Banjo, mjete për higjienën dentale dhe personale	Të mësuarit e aftësisë së përdorimit të banjos dhe higjienës personale	Mbështetje në procedurat e banjos	Funksionet
23	Punësimi në kuadër të programeve të punës ekzistuese në SHKK			Zhvillimi i funksioneve		Zhvillimi i funksioneve

Shtojca 2

LISTA E VLERESIMIT TE AFTESIVE DHE NEVOJAVE

AFTESITE NJOHESE		
Aftësia	Mjeti vlerësues	Shkalla e aftësisë nga 1 - 10
Mbajtja në mend (mbamendja)	Testet psikologjike / intervista	
Njohja shenjave joverbale	Intervista me listën e shenjave joverbale	
Niveli i stresit	Testet psikologjike për matjen e nivelit të stresit, ankthit, zemërimit dhe elementeve të tjerë neurotik.	
Përqendrimi i vëmendjes	Testet psikologjike / intervista	
AFTESITE FIZIKE / Psikomotorrike		
Aftësia	Mjeti vlerësues	Shkalla e aftësisë nga 1 - 10
Aftësia e kapjes së objekteve	Testet neuromotorrike / intervista	
Qëndrimi i zgjatur në këmbë	Testet neuromotorrike / tabela e intervalit kohore	
Ecja	Testet neuromotorrike / intervista	
Koordinimit Dorë-Sy	Testet neuromotorrike / intervista	
FUNKSIONET		
Aftësia	Mjeti vlerësues	Shkalla e aftësisë nga 1 - 10
Aftësia për t'u vet veshur	Raportimet dhe vëzhgimet e anëtarëve të ekipit multidisiplinair	
Te ushqyerit e pavarur	Raportimet dhe vëzhgimet e anëtarëve të ekipit multidisiplinair	
Përdorimi i pavarur i banjës	Raportimet dhe vëzhgimet e anëtarëve të ekipit multidisiplinair	
Punësimi	Forma për përcaktimin e aftësisë dhe natyrës së punës	

Shtojca 3

LISTA E MJETEVE TE NEVOJSHME PER ZBATIMIN E UDHEZUESIT

Nr	Mjeti	Specifikat	Sasia	Njësia
1.	Karta standarde te lojës në format fizike		50	sete
2.	Puzzle - seti i copëzave të figurave	Mosha 5-9 vjeçare	50	sete
3.	Rruzaria (rosary)	Madhësi dhe ngjyra të ndryshme, si dhe të gjitha mjetet relevante për këtë aktivitet	80	sete
4.	Emotional Charts	Të plastikuara	20	copë
5.	TV	42" - 51"	4	copë
6.	Katalog me shenja për orientim në hapësira të urbanizuara	Karta fizike të plastikuara me ngjyra	11	copë
7.	Video lojëra	PlayStation 4 ore 5 Intendo etj	6	copë
8.	Topa për loje	Madhësi, forma dhe ngjyra të ndryshme	100	copë
9.	Plasteline	Sete me plastelin, me ngjyra të ndryshme	50	sete
10.	Biofeedback dots	Pika për Biofeedback (https://www.amazon.com/Biodots-SS76-100-Count/dp/B002H4ENEK)	500	sete
11.	Kolltukë për terapi grupore	Kolltukët komode të përshtatshme për terapi grupore	15	copë
12.	Yogamats	Ngjyra te ndryshme	100	copë
13.	Beanbags for adults	Ngjyra te ndryshme	15	copë
14.	Kufje profesionale	Kufje profesionale për dëgjimin e muzikës relaksuese	15	copë
15.	Projektorë	Projektorë për vendosjen e imazheve në mure	4	copë
16.	Pajisje për aromatizim	Aromatizues për dhomën relaksuese	4	copë
17.	Instrumente për terapi muzikore	Sinti, Defi, Bateri (drums), Terabuki, Kitare akustike, kitare klasike,	1	copë
18.	Mjetet e zërimit	Zmadhues elektronik për muzike dhe mikrofonat	2	copë
19.	Bilardo	Tavolinë për lojën e bilardos	2	sete
20.	Futboll i tavolinës	Futboll i tavolinës	4	sete
21.	Pesha për ushtrime të duarve	Nga 0,5 deri në 10kg	20	sete
22.	Trakë e vraptimit	Trakë vraptimi për zhvillimin e aftësive të ecjes	2	copë

23.	Biçikletë statike	Biçikletë statike për zhvillimin e aftësive fizike	2	copë	
24.	Pajisje të fitnesit	Pajisje të fituesi për zhvillimin e aftësive të funksioneve fizike	1	set	
25.	Kuzhine	Kuzhine me te gjitha pajisjet dhe enët për zhvillimin e aftësive për përgatitjen e ushqimeve	1	Set	
26.	Tavolina pune te rrumbullakëta	Tavolina pune të rrumbullakëta për zhvillimin e aktiviteteve	4	sopë	
27.	Rrobalarëse	Për 40 persona	1	copë	
28.	Rroba tharëse	Për 40 persona	1	copë	
29.	Hekur për hekurosje	Hekur dore	3	sopë	
30.	Ngjyra druri	Për ushtrime te aftësive	100	sete	
31.	Ngjyra vaji	Për ushtrime te aftësive	100	sete	
32.	Ngjyra temporo	Për ushtrime te aftësive	100	sete	
33.	Ngjyra qiriu	Për ushtrime te aftësive	100	sete	
34.	Ngjyra permanente	Për ushtrime te aftësive	100	sete	
35.	Gérshërë	Standarde, për ushtrime të aftësive	20	copë	
36.	Pajisje shkollore	Fletore, hamera, fleta pune, lapsa, goma, ngjitësa, vizore, trekëndëshe etj.	100	sete	
37.	Pajisje për realitetin virtual	Szye VR	4	sete	
38.	Shah	standard	4	sete	
39.	Domino	standard	10	sete	
40.					

Referencat

1. American Occupational Therapy Association (AOTA) . (2002) . Occupational therapy practice framework: domain and process . Am J Occup Ther.
2. Commission on Accreditation of Rehabilitation Facilities [CARF] . (2008) . Medical Rehabilitation Standards Manual . Tuscon, AZ : CARF
3. World Health Organization (WHO) . (2001) . International Classification of Functioning, Disability and Health (ICF) . Geneva, Switzerland : WHO .
4. NIMH Tumball, A.P. Strickland, B.B. & Brantley, J.C. (1990) Developing and implementing individualized education programme, London: Merril
5. Carmean, Amber; Boman, Amanda; Kowalski, Katie; and Walsworth, Joselyn, "Occupational Therapy in Prisons" (2019). Community Based. 8.
https://scholarworks.gvsu.edu/ot_community_based/8

Grupi punues

1. Prof. Asoc. Dr. Milazim Gjocaj, MD, MSc, PhD	kryesues
2. Arben Lubach, DSc (KiE)	fascilitues
3. Granit Shatri	anëtar
4. Isa Mehemi	anëtar
5. Naim Hoxha	anëtar
6. Yllka Kryeziu	anëtare
7. Arber Zeka	anëtar
8. Kumrie Haxhiu	anëtare
9. Dr. Ngadhjnim Mehemi	anëtar
10. Jehona Majkovci	anëtare
11. Visar Elshani	anëtar

Grupi punues i zgjeruar

1. Dr. Milazim Gjocaj	DSHB
2. Jehona Majkovci	DSHB
3. Ardit Azemi	DSHB
4. Kumrije Haxhiu	DSHB
5. Behar Mazreku	DSHB
6. Dr. Ngadhnjim Mehmeti	DSHB
7. Hamze Fekaj	DSHB
8. Arber Zeka	DSHB
9. Enrit Bekteshi	DSHB
10. Sabahate Vuthaj	DSHB
11. Arsim Sherifi	SHKK
12. Rame Murtezaj	SHKK
13. Xhavit Sheqiri	SHKK
14. Flake Ymeri	SHKK
15. Hidajete Hyseni	SHKK
16. Granit Shatri	DSHB
17. Vesel Sadrijaj	DSHB
18. Ilir Jakupi	SHKK
19. Faruk Ferataj	SHKK
20. Brikena Mucolli	SHKK
21. Dr. Imet Poniku	DSHB
22. Astrit Rexhaj	DSHB
23. Fatmir Hasanaj	SHKK
24. Rudina Shoshi	DSHB
25. Naim Hoxha	IPFK
26. Arife Veselaj	IPFK
27. Dr. Ngadhnjim Rexhepi	DSHB
28. Isa Mehemeti	DSHB
29. Bojana Vukadinovic	DSHB
30. Dr. Sonja Gerbic	DSHB
31. Sami Hajrullahu	DSHB
32. Shpresa Tafa	ISSH
33. Djellze Haxhiu	ISSH
34. Arben Lubach	KiE
35. Pete Ravander	EULEX
36. Albert Gegaj	EULEX
37. Catharine Cremer	Eksperte, KiE
38. Alban Muriqi	IAPK
39. Shqipe Mala,	MKKPT të IAP

Milazim Gjocaj

From: Niman Bardhi
Sent: Wednesday, August 9, 2023 3:07 PM
To: Naim Bardiqi
Cc: Arsim Qavdarbasha; Minire.Kazazi; Vjosa Kalaja; Lul Raka; Teuta Qilerxhiu; Fakete Hoxha.Haziri; Mentor Sadiku; Fatbardha Murtezi; dritonvela@hotmail.com; Albana Morina; Elton Bahtiri; EDMOND HALITI; edmond.haliti@uni-pr.edu; agron_bytyqi@hotmail.com; Hajrullah Fejza; Milazim Gjocaj; Granit Shatri; Ismail Dibrani
Subject: Njoftim (Explanation of Occupational Therapy 'Guideline')

Inderuari Sekretar, Dr.Naim,

Referuar kërkesës së Dr.Milazim Gjocaj të datës 26.07.202 ku: "DShB se bashku me KE është duke hartuar udhëzuesit / udhërrëfyesit për terapinë okupuese sipas rekondimeve të KE. Në proces e sipër janë ngritë dilemat se a janë këto dokumente udhërrëfyes klinik apo protokolle apo dokumente të tjera që kanë nevojë që të kalojnë sipas proceduarve të Udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike", ju njoftoj se më datë 09.08.2023 është mbajtur takimi i KKUPK, lidhur me sqarimin e emërtimit të dokumentit nga Departamenti i Burgjeve për "Udhëzime dhe Mjete për Terapinë Okupacionale".

Pas sqarimeve të ofruara nga Dr.Milazim Gjocaj, u hoq dilema se a është Udhëzues apo Udhërrëfyes, pasi që kjo kishte ndodhur si pasojë e gabimit në përkthim. Ky dokument është udhëzues për hapat dhe procedurat e terapisë okupacionale që ofrohet nga gardianët, punëtorët social apo terapistët profesional. Po ashtu, Dr.Milazimi theksoi se ky udhëzues nuk ka asnjë implikim financiar që mund të bie në barrë të Ministrisë së Shëndetësisë, pasi që përkrahët nga SHBA dhe BE.

Pas shqyrtimit të materialit nga anëtarët e KKUPK-së që ishin prezent në takim, në mënyrë unanime thanë se në bazë të asaj që është lexuar dhe mënyrës së hartimit/adaptimit të UPK-ve, ky dokument nuk ka të bëjë me UK, por se flitet për një Udhëzues që rregullon një qasje ndaj personave që gjinden në mbajtje e që kanë nevojë për terapi okupacionale, të mësimit të hapave që ata duhet ndjekur për t'u rehabilituar, e jo për procedura klinike.

KKUPK konklidon se në këtë rast nuk bëhet fjalë për Udhërrëfyes Klinik dhe si i tillë nuk bie në fushën e veprimtarisë së KKUPK.

Me respekt,

**MSc.Niman Bardhi, PhDc.
Psikolog Klinik**

Zv. Drejtëor i Departamentit për Zhvillim Strategjik Shëndetësor
Ministria e Shëndetësisë

Email: niman.bardhi@rks-gov.net; nimanbardhi@gmail.com; nimanbardhi@hotmail.com.

Tel. zyre: +383 (0) 38 200 24 105

Tel. mob: +383 (0) 44 352 172; +383 (0) 49 352 172

From: Niman Bardhi
Sent: Thursday, August 3, 2023 12:18 PM
To: 'Lul Raka' <lul.raka@uni-pr.edu>; Teuta Qilerxhiu <Teuta.Qilerxhiu@rks-gov.net>; Fakete Hoxha.Haziri <Fakete.Hoxha.Haziri@rks-gov.net>; Mentor Sadiku <Mentor.Sadiku@rks-gov.net>; Fatbardha Murtezi <Fatbardha.Murtezi@rks-gov.net>; dritonvela@hotmail.com; Albana Morina <Albana.Morina@rks-gov.net>; Elton Bahtiri <elton.bahtiri@uni-pr.edu>; EDMOND HALITI <edihal@yahoo.com>; edmond.haliti@uni-pr.edu; agron_bytyqi@hotmail.com; Hajrullah Fejza <Hajrullah.Fejza@rks-gov.net>; Milazim Gjocaj <Milazim.Gjocaj@rks-gov.net>; Granit Shatri <Granit.Shatri@rks-gov.net>; Ismail Dibrani <Ismail.Dibrani@rks-gov.net>
Cc: Naim Bardiqi <Naim.Bardiqi@rks-gov.net>; Arsim Qavdarbasha <Arsim.Qavdarbasha@rks-gov.net>; Minire.Kazazi <Minire.Kazazi@rks-gov.net>; Vjosa Kalaja <Vjosa.Kalaja@rks-gov.net>
Subject: Njoftim (Explanation of Occupational Therapy 'Guideline')
Importance: High

Të nderuar anëtar të KKUPK,

Me qëllim të dhënjes drejtim të kërkesës së bërë nga Dr.Milazim Gjocaj (shih korespondencën dhe materialin e bashkëngjitur), dhe bazuar në komentet e pranuara nga Prof.Luli dhe Dr.Teuta, ju ftoj të merrni pjesë në takim më 09.08.2023 në ora 10.00 në zyren nr.109 në MSh. Në takim do të merrë pjesë edhe Dr.Milazim Gjocaj.

Po ashtu gjatë këtij takimi do të shqyrtohet edhe kërkesa nga Projkti AQH.

Me respekt,

**MSc.Niman Bardhi, PhD.
Psikolog Klinik**

Zv. Drejtor i Departamentit për Zhvillim Strategjik Shëndetësor
Ministria e Shëndetësisë

Email: niman.bardhi@rks-gov.net; nimanbardhi@gmail.com; nimanbardhi@hotmail.com.

Tel. zyre: +383 (0) 38 200 24 105

Tel. mob: +383 (0) 44 352 172; +383 (0) 49 352 172

From: Lul Raka <lul.raka@uni-pr.edu>
Sent: Tuesday, August 1, 2023 3:09 PM
To: Niman Bardhi <Niman.Bardhi@rks-gov.net>
Cc: Teuta Qilerxhiu <Teuta.Qilerxhiu@rks-gov.net>; Fakete Hoxha.Haziri <Fakete.Hoxha.Haziri@rks-gov.net>; Mentor Sadiku <Mentor.Sadiku@rks-gov.net>; Fatbardha Murtezi <Fatbardha.Murtezi@rks-gov.net>; dritonvela@hotmail.com; Albana Morina <Albana.Morina@rks-gov.net>; Elton Bahtiri <elton.bahtiri@uni-pr.edu>; EDMOND HALITI <edihal@yahoo.com>; edmond.haliti@uni-pr.edu; agron_bytyqi@hotmail.com; Hajrullah Fejza <Hajrullah.Fejza@rks-gov.net>; Milazim Gjocaj <Milazim.Gjocaj@rks-gov.net>; Granit Shatri <Granit.Shatri@rks-gov.net>; Ismail Dibrani <Ismail.Dibrani@rks-gov.net>
Subject: Re: FW: Explanation of Occupational Therapy 'Guideline'

Të nderuar/a,

Mendoj se në sfond kemi dy qasje të kundërtë, të cilat shikuar ndarazi kanë të drejtë.

Ka të drejtë Sekretari, sepse shteti dhe KKPUK punojnë sipas kornizës aktuale ligjore.

Por, ka të drejtë edhe Dr.Milazimi, i cili kërkon zgjidhje për të burgosurit, sepse rehabilitimi personave në burgje është po ashtu obligim ligjor i MSh.

Kërkesa e Departamentit të Burgjeve është edhe një argument shtesë se korniza e Udhëzimit Administrativ duhet të ndryshojë, ashtu siç ju kam shkruar në e-mailin e dërguar para disa javëve.

Fillimisht problemi është te terminologjia: a është protokol, udhëzues apo udhërrëfyes. Nëse shikohet dokumenti dhe kërkesa për terapi okupacionale, aty shihet se nuk bëhet fjalë për kurrfarë terapie medikamentoze as trajtim të të burgosurve, por për 4 aktivitete të terapisë okupacionale:

- Si të mësohet individi për veshjen dhe domosdoshmërinë e saj
- Si të mësojë mënyrat e shëndetshme të ushqyerjes
- Si të mësohet ta përdorë tualetin dhe
- Si të përgatitet për punësim afatgjatë.

Asnjëra nga këto procedura banale nuk kanë lidhje me KKUPK.

Por, ato kërkojnë zgjidhje nga Ministria e Shëndetësisë, e cila duhet ta gjejë një rrugë tjeter për ta miratuar, sepse ligji aktual i shëndetit mendor i Kosovës, Neni 3 thotë: "Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet shërbimeve të shëndetit mendor, sipas nevojave ofron asistencën e duhur për diagnostikimin, kurimin dhe **reabilitimin e të sëmurëve me çrregullime mendore që mbahen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.**"

SHEMBUJT NËPËR BOTË

Nëpër shtete të ndryshme të botës, dokumentet zyrtare për terapinë okupacionale zakonisht miratohen nga organet profesionale përkatëse, agjencitë rregullatore dhe bordet institucionale, varësisht nga juridiksioni dhe natyra specifike e dokumenteve. Ja disa shembuj të institucioneve që bëjnë miratimin e këtyre dokumenteve:

- Organizatat profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare - që merren me terapinë okupacionale.
- **Organet rregullatore: Ministria e Shëndetësisë ose bordet e licencimit.**
- Institucionet shëndetësore: spitalet, qendrat e rehabilitimit dhe institucione të tjera shëndetësore.
- Komitetet e Etikës: nëse udhëzuesi, protokolli apo udhërrëfyesi përfshin hulumtime ose trajtime innovative në njerëz.
- Ofruesit e sigurimeve shëndetësore: nëse mbulojnë këto lloje trajtimit.

Gjitha te mirat,

Luli

On Fri, Jul 28, 2023 at 3:16 PM Niman Bardhi <Niman.Bardhi@rks-gov.net> wrote:

Të nderuar,

Duke ditur se jemi në kohë të pushimeve, me mirësi kërkoj nga ju që të analizoni kërkesën e parashtruar nga Dr.Milazim Gjocaj (shih korespondencën dhe materialin e bashkëngjitur), dhe sa më parë që mundeni (brenda një javë) të ofroni opinionin tuaj si anëtar të **KKUPK**.

Me respekt,

MSc.Niman Bardhi, PhD.

Psikolog Klinik

Zv. Drejtor i Departamentit për Zhvillim Strategjik Shëndetësor

Ministria e Shëndetësisë

Email: niman.bardhi@rks-gov.net; nimanbardhi@gmail.com; nimanbardhi@hotmail.com.

Tel. zyre: +383 (0) 38 200 24 105

Tel. mob: +383 (0) 44 352 172; +383 (0) 49 352 172

From: Milazim Gjocaj <Milazim.Gjocaj@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, July 26, 2023 8:10 AM
To: Niman Bardhi <Niman.Bardhi@rks-gov.net>
Cc: Hajrullah Fejza <Hajrullah.Fejza@rks-gov.net>; Granit Shatri <Granit.Shatri@rks-gov.net>; Ismail Dibrani <Ismail.Dibrani@rks-gov.net>
Subject: FW: Explanation of Occupational Therapy 'Guideline'

I nderuar zoti Bardhi,

DShB se bashku me KE është duke hartuar udhëzuesit / udhërrëfyesit për terapinë okupuese sipas rekomandimeve të KE.

Në proces e sipër janë ngritë dilemat se a janë këto dokumente udhërrëfyes klinik apo protokolle apo dokumente të tjera që kanë nevojë që të kalojnë sipas proceduarve të Udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike.

Ne kemi konsideruar se këto dokumente janë udhëzues apo manual për të kryer aktivitete psiko sociale dhe për të hequr dilemat kemi kërkuar nga ekspertet e fushës nga KE, Prof Cathrine dhe Prof. Aliriza Arënliu që të na japin sqarime shtesë.

Këto aktivitete janë të parapara të zbatohen nga psikologët, punëtorët social, gardianet dhe instruktorët e ShKK.

Bazuar në ketë sqarime shtesë, në Raportin e KE dhe në disa shembuj të këtyre aktiviteteve, në cilësinë e këtij Komiteti, kërkojmë nga ju që të shikoni këtë dokument dhe të vlerësoni se si të klasifikohen.

Në rast se janë Udhërrëfyes Klinik, atëherë të fillohet nga e para për të respektuar procedurat.

Në rast se janë vetëm udhëzues apo manual për punë të aktiviteteve psikosociolae siç pretendohet, të vazhdohet me punë ku ka mbetur projekti i KE.

Për çdo sqarim shtesë ju lutem më kontaktoni në çdo kohë mua dhe Z. Shatri.

Me respekt!

Prof. Asoc. Dr. Milazim H. Gjocaj, MD, MSc, PhD;

Specialist i Ekologjisë Humane, Shëndetësi Publike

Drejtor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë,

Email: Milazim.Gjocaj@rks-gov.net

Link: <https://msh.rks-gov.net/Department/Index/10?type=1>

Private: milazimgjocaj@gmail.com

Tel Zyre: +383(0)38212837; Centrex: 24 161

Tel mob: +383(0) 44 158 671

From: LUBACH Arben [mailto:arben.lubach@coe.int]
Sent: Tuesday, July 25, 2023 11:22 AM
To: Milazim Gjocaj <Milazim.Gjocaj@rks-gov.net>; Granit Shatri <Granit.Shatri@rks-gov.net>
Cc: JASHANICA Majlinda <majlinda.jashanica@coe.int>
Subject: FË: Explanation of Occupational Therapy 'Guideline'

Te nderuar Zt. Gjocaj dhe Zt Shatri,

Pas nje bisede qe kisha me dy konsulentet/expertet tane (shih korrespondecat me poshte), ne lidhje me natyren e udhezuesve (guidelines) qe kemi zhvilluar per Terapi Okupuese mund te shihni se qe te dy deklarojne se keto udhezues jane kryesisht te natyres psikosociale te cilat ndihmojne ne trajtimin e pacienteve me probleme mendore. Natyrisht, keto mund te aplikohen edhe nga ekspert multidisciplinare ku mund te perfshihen edhe ekspert shendetlore, por sic edhe ka theksuar Dr. Creamer (shih emailin e saj me poshte ne anglisht) '*...eshte me rendesi qe t'i shmangemi cfaredo perkthimi [ne gjuhen shqipe] qe mund te jep indikacione se udhezuesit mund te jene te natyres mjeksore*'.

Njeherit, edhe Profesori Arenliu jep nje sqarim te ngjashem dhe te detajuar.

Gjithashtu, me lejoni t'ju perkujtoj edhe faktin se gjate grupit punues eshte theksuar shume here nga ekspertet tane se terapia okupuese mund te ofrohet jo vetem nga psikologet, por edhe nga puntoret social, sociologet, dhe nga shume profesionit tjere te sjelljes (behavioural), e madje edhe nga vet zyrtaret korrektues, gardianet respektivisht.

Andaj, marre parasysh keshillat dhe pikepamjet e eksperteve tane, ju kisha sygjeruar qe te zevendesohet termi 'udherrefyes' me termin e sakte te parapare me Projekt, gjegjesisht 'udhezues per aktivitete psikosociale'.

Njeherit, me lejoni t'ju perkujtoj se Objektiva e Projektit qe po implementojme gjithmone ka qene zhvillimi i nje udhezuesi psikosocial i dedikuar ne rend te pare per psikolog, puntore social, dhe ekspert te tjere te sjelljes (behavioural experts).

Sincerisht,

Arben Lubach



Senior Project Officer / Project Manager (Field)

Improvement of the treatment of persons deprived of liberty
Council of Europe - Conseil de l'Europe

Office: +383 (0)38 40 77 66

Mob: +383 (0)49 11 55 66

arben.lubach@coe.int

<https://eeë.coe.int>

<https://eeë.coe.int/cndl>

From: Catherine Creamer <catherinejcreamer@gmail.com>

Sent: Monday, July 24, 2023 11:44 AM

To: Aliriza Arënliu <aliriza.arenliu@uni-pr.edu>

Cc: LUBACH Arben <arben.lubach@coe.int>; JASHANICA Majlinda <majlinda.jashanica@coe.int>

Subject: Re: Explanation of Occupational Therapy 'Guideline'

Hi Arben

I think it's important to move away from the term manual, and stick with something in the region of general guidelines (rather than guide), for the assessment and delivery of occupational therapy services. It's important to also move away from any translation that could imply a medical model. Occupational therapy is a recovery model, so general guidelines should be more appropriate.

In-terms of the OT activity, I think these are less of a manual and more of a 'guide' to psychosocial activities that can be run for mental health patients that have been shown to be helpful in their recovery, especially if run by multi-disciplinary teams.

Kind regards

Catherine

Sent from my iPhone

On 24 Jul 2023, at 19:23, Aliriza Arënliu <aliriza.arenliu@uni-pr.edu> wrote:

Dear Arben and Catherine,

Here is my line of thinking. The easiest way is to avoid using terminology that is specified in Kosovo Health Law example: "protokol" or "Udherrefyes" and use instead "Udhezues" or "Udhezues per praktika të mira të terapise okupuese në DSHB" or "Instruksione per praktika të mira të terapise okupuese në DSHB".

Beloë are some differences in general terminology of ëordings uses the protocol, manual or guide, ëhich in Albanian can be used as "udhezues", "praktika më të mira" or "instruksione".

Tëo points belloë are taken from <https://www.bettal.co.uk/understanding-the-difference-between-policies-procedures-protocols-and-guidance-pppgs>,
<https://www.hse.ie/eng/about/who/directorembers/codeofgovernance/codeofgov8pppgs.pdf>

Ëhat is a protocol?

A protocol is a written plan that specifies procedures to be followed in defined situations: A protocol represents a standard of care that describes an intervention or set of interventions. Protocols are more explicit and specific in their detail than guidelines; in that, they specify who does 'ëhat', 'ëhen' and 'hoë' (HSE, 2012).

Ëhat is a guideline?

A guideline is defined as a principle or criterion that guides or directs action. Guideline development emphasises using clear evidence from the existing literature, rather than expert opinion alone (HSE, 2011).

Doing the right thing consistently to ensure the best possible outcomes for patients and service users, satisfaction for all customers, retention of talented staff and a good financial performance. (Leahy, 1998).

Medical Guide?

A medical guide is a document that offers practical, concise, and user-friendly guidance on a particular medical procedure, treatment, or aspect of patient care. Unlike a comprehensive medical manual, a medical guide is more focused and tailored to address a specific medical issue or procedure. It is often designed to be accessible and easy to follow for healthcare practitioners and patients alike.

From the three options above, the Guide looks closer to ëhat ëe have done for occupational therapy. The guide goes through less strict procedures of approval ëhen compared to protocols or manuals.

Prof. Dr. Aliriza Arënliu,

Faculty of Philosophy, Department of Psychology, #211

University of Prishtina, Hasan Prishtina

Mother Theresa nn, 10000, Prishtine, Kosova

On Mon, Jul 24, 2023 at 10:50 AM LUBACH Arben <arben.lubach@coe.int> ërote:

Dear both,

Writing to ask for your professional and expert opinion and explanation on our recent activity where we developed the first draft of the Manual on Occupational Therapy. More specifically, I am referring to the terminology - namely the word 'manual', which can be understood in two ways in Albanian (Aliriza knoës ëhat I mean). On one hand it can be understood as a 'guide', which explains and directs behavioral professionals (psychologists, social workers etc, or even correctional staff [prison guards]), or a multi-disciplinary team that could also include a medical professional working together with behavioral professionals, towards the application of the said therapy. On the other hand, it can also mean a medical guide, a protocol of sort if you wish, that foresees specific steps that need to be undertaken by medical experts as the main professionals responsible for the delivery of Occupational Therapy (to also include administration of medicaments).

The matter is rather urgent, so I would be very grateful for your insight and explanation on this.

Kind regards,

Arben Lubach



Senior Project Officer / Project Manager (Field)

Improvement of the treatment of persons deprived of liberty
Council of Europe - Conseil de l'Europe

Office: +383 (0)38 40 77 66

Mob: +383 (0)49 11 55 66

arben.lubach@coe.int
<https://eeę.coe.int>

<https://eeę.coe.int/cpdl>